

Aktualisht mban postin e Drejtorit të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun (Median) dhe me Jashtë në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë. Ka lindur në Tiranë në 1980, është e martuar dhe ka një djalë.

Është diplomuar për Gazetari në Fakultetin e Filologjisë, në Universitetin e Tiranës në vitin 2002. Në vitin 2009 ka përfunduar studimet për Drejtësi në Fakultetin e Drejtësisë, Tiranë dhe në vitin 2011 ka përfunduar studimet Master i Nivelit të Dytë për Shkenca Penale, pranë Universitetit të Tiranës. Gjatë viteve 2000 - 2003 ka ushtruar profesionin e gazetares në median vizive. Prej nëntorit 2003 – Shtator 2005 ka ushtruar detyrën e Këshilltares së Marrëdhënieve me Median e me Jashtë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Prej muajit shtator 2005 – shkurt 2021 ka ushtruar detyrën e Përgjegjëses së Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun dhe Median në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë.

Ka marrë pjesë në trajnime kombëtare e ndërkombëtare në fushën e medias, institucioneve e shtetit të së drejtës. Zotëron tre gjuhë të huaja: anglisht, italisht dhe frëngjisht.